

Për çfarë është kjo fletëpalosje?

Mund të jetë mjaft e frikshme të shkoni në një shtëpi të re dhe kur nuk e dini kush janë njerëzit dhe çfarë po bëjnë, mund t'ju bëjë të ndiheni të hutuar dhe të vetmuar.

Të gjitha ndryshimet që po ju ndodhin tani, dhe njerëzit që janë rreth jush, si kujdestarët, punonjësit socialë dhe punonjësit e rasteve të migracionit mund të jenë të sikletshme. Largimi nga shtëpia e kujdestarit tuaj dhe shkëputja mund të ndihen si opsioni i vetëm që keni, por kjo mund të çojë në një rrezik shumë të madh.

Kujdestarët tuaj dhe punonjësi social do t'ju mbështesin për të marrë të gjitha shërbimet që ju keni nevojë dhe t'ju përgjigjet çdo pyetje që mund të keni.

Nëse ndiheni i pasigurt :

Mundohuni t'i tregoni kujdestarit tuaj ose punonjësit social se çfarë po ndodh. Kjo mund të jetë e vështirë për ta bërë, por ata do t'ju dëgjojnë.

Në Mbretërinë e Bashkuar, policia do t'ju mbrojë, në mënyrë që t'i tregoni nëse jeni i shqetësuar se dikush do t'ju lëndojë.

Nëse largoheni nga banesa e kujdestarëve tuaj dhe nuk u tregoni se ku po shkoni dhe nuk ktheheni kur thoni se do të ktheheni, ata do të duhet të thërrasin policinë. Ju nuk do të jeni në telashe, por kujdestari juaj dhe punonjësi social do të duan t'ju gjejnë për t'u siguruar që jeni shëndoshë e mirë.

**NËSE JU DUHET NDIHMË URGJENTISHT
POLICIA - ZJARRFIKËSIT - AMBULANCA
TELEFONONI 999 DHE KËRKONI NDIHMË**

Kujdestari

Emri:

Telefoni:

Punonjësi social

Emri:

Telefoni:



Fletëpalosje mirëseardhjeje



**National
Counter
Trafficking
Service**

Believe in
children
Barnardo's

CROYDON | Delivering
www.croydon.gov.uk | for Croydon

 **IOM** UN
MIGRATION

Çfarë është një kujdestar, punonjës social dhe punonjës i imigracionit dhe çfarë bëjnë ata?

Kujdestarët (**foster carers**) janë njerëz të zakonshëm që hapin zemrat dhe shtëpitë e tyre për të ofruar një jetë familjare të qëndrueshme për të rinjtë që nuk janë në gjendje të jetojnë me prindërit e tyre. Kujdestarët ofrojnë një shtëpi të sigurt dhe të parrezikshme ku të rinjtë ndihen të vlerësuar, të respektuar dhe ku për ta kujdesen kujdestarët. Kujdestarët i kushtojnë shumë vëmendje jetës së të rinjve për të cilët ata kujdesen.

Punonjësi social (**social worker**) është dikush që punon për të ndihmuar njerëzit kur ata kanë më shumë nevojë. Punonjësi juaj social do t'ju ndihmojë me shumë aspekte të jetës suaj dhe do të jetë pika kryesore e kontaktit për ju dhe profesionistë të tjerë që punojnë me ju, si kujdestari juaj. Punonjësi social do të sigurohet që ju të kuptoni se çfarë po ndodh me ju dhe t'ju ndihmojë të merrni vendime.

Nëse kërkoni azil ju do të takoheni me një avokat të imigracionit i cili do të ofrojë këshilla ligjore dhe ndihmë me kërkesën tuaj për imigracionin. Pastaj do të takoheni me një punonjës të imigracionit i cili do të bëjë një intervistë për mirëqenien (**Welfare Interview**) dhe më pas një intervistë më e gjatë (**Substantive Interview**).

Një përkthyes do t'ju mbështesë ju të shpjegoni arsyet që keni lënë vendin tuaj, çfarë ju ndodhi gjatë udhëtimit dhe çfarë ju ka ndodhur që nga mbërritja në Mbretërinë e Bashkuar.



Të ndihesh që kujdesen për ty në UK do të thotë të ndihesh i sigurtë, i ushqyer dhe i përfshirë, dhe të jesh i shëndetshëm, i inkurajuar dhe i respektuar. Si duket kjo?

Ndjenja e sigurisë do të thotë ...

Ju ndiheni të mbrojtur nga lëndimet brenda shtëpisë suaj dhe ju e dini kur gjërat janë të rrezikshme dhe përpiqeni të qëndroni larg rrezikut

Ju nuk keni frikë kur dilni jashtë dhe përreth

Të jesh i shëndetshëm do të thotë...

Kujdestarët tuaj ju ndihmojnë që të hani mirë, të bëni ushtrime fizike dhe të merrni ndihmë nëse ndiheni i sëmurë

Ju ndiheni i aftë të përballeni me situata që mund të ndeshni në jetë

Ndjenja e përfshirjes do të thotë...

Ju mendoni se jeni pjesë e tyre kur jeni me miqtë tuaj, kujdestarët dhe në shkollë ose kolegji

Ju takoni shumë njerëz të ndryshëm dhe mendoni se njerëzit e tjerë përreth ju duan

T'ju nxisin do të thotë ...

Ju po mësoni aftësi të reja dhe jeni i sigurt se mund të ecni mirë

Kujdestari juaj ju nxit të bëni më të mirën që mundeni

Të ndihesh i mbështetur do të thotë...

Ju jetoni në një shtëpi që është e pastër dhe e ngrohtë dhe ndiheni se njerëzit që jetojnë atje kujdesen për ju

Në shtëpi, kujdestarët tuaj ju dëgjojnë kur keni nevojë për ta dhe ju ndihmojnë të mësoni të kujdeseni për veten dhe të merrni vendimet tuaja

Të jesh i respektuar do të thotë...

Ju mendoni se njerëzit ju dëgjojnë para se të marrin vendime që ndikojnë mbi ju dhe jeni i përfshirë në marrjen e vendimeve për jetën tuaj

Keni njerëz që do t'i dëgjojnë dhe do t'i mbështesin pikëpamjet e vendimet tuaja